

## **Hapet thirrja për aplikim për bursa në programin Mevlana Exchange, për studentët dhe stafin akademik për mësimdhënie, për semestrin e parë të vitit akademik 2019-2020, në Universitetin e Trakya.**

Në kuadër të programit Mevlana Exchange është hapur thirrja për aplikim për bursa shkëmbimi për vitin akademik 2019-2020. Mevlana Exchange Programme është një program i cili mundëson shkëmbimin e studentëve dhe stafit akademik midis Universitetit të Tiranës dhe Universitetit të Trakya.

Studentët e nivelit bachelor dhe stafi akademik nga Universiteti i Tiranës kanë mundësinë të aplikojnë në Universitetin e Trakya-s në Turqi për bursa shkëmbimi.

### **Kushtet e aplikimit për studentët:**

- **Studentët që aplikojnë për periudhë shkëmbimi në Universitetin e Trakya:**
  - Të jenë të regjistruar në Universitetin e Tiranës në programin bachelor.
  - Të kenë një mesatare (GMA) së paku 2,5 në një shkallë me katër pikë.
  - Të njohin gjuhën e mësimdhënies së departamentit në Universitetin e Trakya. Kini kujdes: Gjuha e mësimdhënies në Universitetin e Trakya për pjesën më të madhe të lëndëve është Turqishtja. Për departamentin e Anglishtes gjuha e mësimdhënies është anglishtja; për departamentin e gjuhës gjermane lëndet zhvillohen në gjermanisht.
  - Studentët duhet të kenë një certifikatë të gjuhës turke, angleze apo gjermane në varësi të programit të tyre të studimit.

### **Dokumentacioni për aplikim për studentët:**

Dokumentat e nevojshme për aplikim mund të shkarkohen në seksionin “Candidate Student Application Form” në adresën <http://mevlana.trakya.edu.tr/>.

Konkretisht dokumentat që duhet të dorëzohen janë:

- Candidate Student Application Form ( <https://mevlana.trakya.edu.tr/pages/belgeler> );
- Listë Notash;
- Certifikata e Gjuhës.

### **Kompensimi financiar për studentët:**

- Bursa për studentët është 1200 TL (Turkish Lira) për çdo muaj. 80% e sasisë së bursës paguhet çdo muaj. Për pjesën tjetër të mbetur të bursës, do të merret në konsideratë niveli i suksesit të studentit në fund të shkëmbimit.
- Studentët e paguajnë pagesën e shkollimit në universitetin e vendit të tyre, pra ku ata janë regjistruar dhe nuk paguajnë asnjë pagesë tjetër shkollimi në universitetin pritës.
- Kostot e udhëtimit dhe akomodimit mbulohen nga vetë aplikantët.

## Kushtet e aplikimit për stafin:

### ➤ Staf i akademik i Universitetit të Tiranës:

- Staf i akademik kërkohet që të ketë aftësi të mira të gjuhës. (Gjuha e mësimdhënies në Universitetin e Trakya është Turqishtja, përveç disa departamenteve si ai i Gjuhës Gjermane, Shqipe, Angleze, Greke, Boshnjake).
- Dokumentacioni për aplikim përfshin dokumentin Instructor Mobility Program, të cilin mund ta shkarkoni në adresën <https://mevlana.trakya.edu.tr/pages/belgeler>.

## Fushat e shkëmbimit dhe kohëzgjatja për studentët e nivelit Bachelor:

Fusha		Instiucioni i Arsimit të Lartë		Kohëzgjatja (muaj)
Kod i	Fusha e Studimit	Institucioni dërgues	Institucioni Pritës	
14.3	<b>Ekonomik</b> Fakulteti i Ekonomisë (Departamenti i Ekonomiksit)	Universiteti i Tiranës	Universiteti i Trakya	4 muaj
04.0	<b>Studime Biznesi, Shkenca e Menaxhimit.</b> Fakulteti i Ekonomisë (Departamenti i Menaxhimit)	Universiteti i Tiranës	Universiteti i Trakya	4 muaj
08.3	<b>Histori</b> Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë (Departamenti i Historisë)	Universiteti i Tiranës	Universiteti i Trakya	4 muaj
05.9	<b>Të tjera Edukim</b> Fakulteti i Gjuhëve të Huaja. (Departamenti i Anglishtes)	Universiteti i Tiranës	Universiteti i Trakya	4 muaj
05.9	<b>Të tjera Edukim</b> Fakulteti i Gjuhëve të Huaja.	Universiteti i Tiranës	Universiteti i Trakya	4 muaj

	(Departamenti i Gjuhës Gjermane)			
13.1	<b>Biologji</b> Fakulteti i Shkencave të Natyrës (Departamenti i Biologjisë)	Universiteti i Tiranës	Universiteti i Trakya	4 muaj
13.3	<b>Kimi</b> Fakulteti i Shkencave të Natyrës (Departamenti i Kimisë)	Universiteti i Tiranës	Universiteti i Trakya	4 muaj
11.1	<b>Matematikë</b> Fakulteti i Shkencave të Natyrës (Departamenti i Matematikës)	Universiteti i Tiranës	Universiteti i Trakya	4 muaj
08.4	<b>Arkeologji</b> Departamenti i Historisë dhe Filologjisë (Departamenti i Arkeologjisë)	Universiteti i Tiranës	Universiteti i Trakya	4 muaj
09.8	<b>Shkenca Filologjike</b> Fakulteti i Gjuhëve të Huaja (Departamenti i Gjuhëve Sllavo-Balkanike)	Universiteti i Tiranës	Universiteti i Trakya	4 muaj

**Fushat e shkëmbimit dhe kohëzgjatja për stafin akademik:**

Kodi	Fusha e Studimit	Institucioni dërgues	Institucioni pritës	Kohëzgjatja totale në periudhë	Orët javore të kursit
14.3	<b>Ekonomik</b> Fakulteti i Ekonomisë	Universiteti i Tiranës	Universiteti i Trakya	2 javë	12 orë

	(Departamenti i Ekonomiksit)				
04.0	<b>Studime Biznesi, Shkenca e Menaxhimit</b> Fakulteti i Ekonomisë (Departamenti i Menaxhimit)	Universiteti i Tiranës	Universiteti i Trakya	2 javë	12 orë
08.3	<b>Histori</b> Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë (Departamenti i Historisë)	Universiteti i Tiranës	Universiteti i Trakya	2 javë	12 orë
05.9	<b>Të tjera Edukim</b> Fakulteti i Gjuhëve të Huaja. (Departamenti i Anglishtes)	Universiteti i Tiranës	Universiteti i Trakya	2 javë	12 orë
05.9	<b>Të tjera Edukim</b> Fakulteti i Gjuhëve të Huaja. (Departamenti i Gjuhës Gjermane)	Universiteti i Tiranës	Universiteti i Trakya	2 javë	12 orë
13.1	<b>Biologji</b> Fakulteti i Shkencave të Natyrës (Departamenti i Biologjisë)	Universiteti i Tiranës	Universiteti i Trakya	2 javë	12 orë
13.3	<b>Kimi</b> Fakulteti i Shkencave të Natyrës (Departamenti i Kimisë)	Universiteti i Tiranës	Universiteti i Trakya	2 javë	12 orë
11.1	<b>Matematikë</b> Fakulteti i Shkencave të Natyrës (Departamenti i Matematikës)	Universiteti i Tiranës	Universiteti i Trakya	2 javë	12 orë

08.4	<b>Arkeologji</b> Departamenti i Historisë dhe Filologjisë (Departamenti i Arkeologjisë)	Universiteti i Tiranës	Universiteti i Trakya	2 javë	12 orë
09.8	<b>Shkenca Filologjike</b> Fakulteti i Gjuhëve të Huaja (Departamenti i Gjuhëve Sllavo- Ballkanike)	Universiteti i Tiranës	Universiteti i Trakya	2 javë	12 orë

**Afati i aplikimit:** 28 Shkurt 2019

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë në Rektoratit e Universitetit të Tiranës si edhe të skanuara përmes adresës [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al).

Studentët dhe stafi akademik mund të shkarkojnë formularët e aplikimit nga faqja e internetit të Universitetit të Trakya: <https://mevlana.trakya.edu.tr/pages/belgeler>.

Për më shumë informacion mbi bursat vizitoni <http://mevlana.trakya.edu.al> ose kontaktoni me Zyrën e Programit të Shkëmbimit Mevlana [mevlana@trakya.edu.tr](mailto:mevlana@trakya.edu.tr).